



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 prill 2024
Nr. ref.:RK 2420/24

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI268/23

Parashtrues

Hysen Shehu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së aktit të paspecifikuar**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka - Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hysen Shehu, nga Prizreni (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilin akt të autoritetit publik e konteston.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) i janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 dhjetor 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 dhjetor 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [GJR.KI268/23], caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe përmes Vendimit [KSH.KI268/23] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 21 dhjetor 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi të: (i) plotësonte formularin e kërkesës; (ii) të specifikonte se cilin vendim të autoritetit publik e konteston; (iii) të saktësonte cilat të drejta dhe liri kushtetuese pretendon se i janë shkelur; si dhe (iv) të bashkëngjiste dokumentet e nevojshme, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
8. Më 11 janar 2024, Gjykata e njoftoi përsëri parashtruesin e kërkesës dhe kërkoi dokumentet e njëjta, në afatin prej 7 (shtatë) ditësh.
9. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 26 mars 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

11. Bazuar në kërkesën që e ka dërguar në Gjykatë, duket që parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie pune në Korporatën Energjetike të Kosovës. Pasi ishte larguar nga puna, Gjykata Themelore në Prizren kishte marrë vendim për kthimin e tij në vendin e punës dhe caktimin e dëmshpërblimit financiar. Mesa duket Gjykata Supreme e ndryshoi vendimin në dëm të parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Themelore në Prizren vendosi që ai t'i kthej paratë në vlerë prej 5.463.17 euro, që i ishin dhënë në formë të dëmshpërblimit për periudhën kohore që ishte larguar nga puna nga Korporata Elektro-energjetike e Kosovës.
13. Parashtruesi i kërkesës pretendon që ish-kolegët e tij të punës që ishin larguar nga puna bashkë me të, kishin marrë dëmshpërblim financiar dhe ishin kthyer në vendin e punës sipas vendimeve të Gjykatës Supreme.
14. Parashtruesi i kërkesës thekson se *“tek rasti im, pasi që më është dhënë dëmshpërblimi financiar në vlerë 5.463.17 euro, pas 4 muajsh është marrë vendim dhe po kërkohet nga unë që t'i kthej të gjitha”*.
15. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që ta shqyrtojë të gjithë lëndën dhe të marr vendim të drejtë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Gjykata shqyrton nëse në rastin konkret janë plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara me Ligj dhe Rregullore të punës.
17. Sipas paragrafit 1 të nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Paragrafi 7 i nenit 113 përcakton që individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
18. Bazuar në nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, Gjykata pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore. Ndërkaq, neni 48 [Saktësimi i kërkesës] i Ligjit parasheh që parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj. Rregulli 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) i Rregullores së punës parasheh që kërkesa e parashtruesve duhet të përmbajë, ndër të tjera, (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës. Sipas nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit, nëse kërkesa ose përgjigjja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Rregulli 54 (2) (a) [Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] i Rregullores së punës përcakton që Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose të qartësojë kërkesën.
19. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatë, e cila është e paqartë. Kërkesa nuk përmban përmbledhjen e fakteve; arsyetimin rreth meritave dhe dokumentacionin mbështetës.
20. Gjykata më 21 dhjetor e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësonte formularin e kërkesës; të specifikonte aktin e autoritetit publik që e kontestonte; të cekte të drejtat dhe liritë të cilat pretendonte se i janë shkelur dhe të bashkëngjiste dokumentacionin mbështetës. Parashtruesi i kërkesës e pranoi njoftimin e Gjykatës më 27 dhjetor 2023, mirëpo nuk iu përgjigj kërkesave të Gjykatës.
21. Më 11 janar 2024, Gjykata përsëri kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të plotësonte kërkesën e tij sipas kriterëve ligjore. Parashtruesi i kërkesës e pranoi kërkesën e Gjykatës

më 15 janar 2024, mirëpo as kësaj radhe nuk e plotësoi kërkesën dhe nuk dorëzoi asnjë përgjigje në Gjykatë.

22. Gjykata rithekson se barra për të ndërtuar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesin e kërkesës. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për plotësimin e kërkesës dhe qartësimin e tyre, Gjykata i shpall ato si jo të plota dhe nuk i shqyrton në merita (rastet e Gjykatës, [KI133/23](#), parashtrues *Musli Mehmetaj*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 14 nëntorit 2023, para. 30; [KI135/21](#), parashtrues *Isuf Musliu*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 10 shtatorit 2021, para. 35; [KI89/18](#), parashtrues *Agim Jashari*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 27 nëntorit 2018, para. 29).
23. Gjykata rithekson se në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës parashtrroi një kërkesë të paqartë në Gjykatë, dhe përkundër dy kërkesave të Gjykatës për ta plotësuar dhe qartësuar kërkesën e tij, brenda afateve ligjore, parashtruesi i kërkesës nuk u përgjigj.
24. Në bazë të rregullit 54 (2) (a) të Rregullores së punës, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e paqartë dhe jo e plotë, prandaj vendos se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 54 (2) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 26 mars 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e publikimit në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese



Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani